



Shoqëria Audituese : `` Tirana Auditing 3 `` sh.p.k. NIUS : L 61606046 F
Adresa : Njësia Bashkiake Nr.7, Rr. e Kavajës, Ndërtesa 50, Qendra Biznesit ``Gurten,, Tiranë , Albania
Mob. : 068 90 38 114
Tel. : + 355 4 2266890
E-mail : tiranaauditing3@gmail.com , drilona_ceci@yahoo.com

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar : Asamblesë të anëtarëve të Shoqatës "FABER COLLECTIVE PHONOGRAM" OJF

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri/ 233, Ap. 31, Zona Kadastrale 8270,

T I R A N Ë - A L B A N I A

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të **Shoqatës " FABER COLLECTIVE PHONOGRAM " OJF**, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën **31 Dhjetor 2024**, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve (pasqyrën e aktiviteteve të performancës), pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të **Shoqatës " FABER COLLECTIVE PHONOGRAM " OJF** më datën **31 Dhjetor 2024**, performancën e aktiviteteve dhe flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Ligjin nr. 8788 datë 07.05.2001 " Për organizatat jo fitim prurëse ", Ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 " Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardin Kombëtar të Kontabilitetit në zbatim të urdherit Nr 62 datë 17.09.2015 Për shpalljen e standartit kombëtar të kontabilitetit të OJF- ve dhe zbatimin e detyrueshëm të tij.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (**SNA-të**). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga OJF në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri , dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.



Shoqëria Audituese : `` Tirana Auditing 3 `` sh.p.k. NIUS : L 61606046 F
Adresa : Njësia Bashkiake Nr.7, Rr. e Kavajës, Ndërtesa 50, Qendra Biznesit ``Gurten,, Tiranë , Albania
Mob. : 068 90 38 114
Tel. : + 355 4 2266890
E-mail : tiranaauditing3@gmail.com , drilona_ceci@yahoo.com

Përgjegjësitë e drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (**SKK-të**) që zbatohen në Shqipëri për OJF dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare , drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e OJF për të vazhduar në vijimësi duke dhënë informacion , nëse është e zbatueshme , për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë OJF ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë ngarkuar me drejtimin e OJF janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të OJF.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritët që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Një përshkrim më i detajuar i përgjegjësisë së audituesit për auditimin e pasqyrave financiare mund të gjendet në faqen e internetit të **IAASB** në: www.iaasb.org Ky përshkrim përbën pjesë të raportit tonë të auditimit .

`` Tirana Auditing 3 `` sh.p.k. - Ekspert Kontabël i Regjistruar

28.03.2025

Drilona ÇEÇI
Auditues ligjor

DRILONA ÇEÇI

[Signature]

